



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, nenit 17 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 3/L-040, të dt. 20 shkurt 2008, dhe të nenit 16, par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.5.2009, merr

**V E N D I M**  
**PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES**  
**“PRISHTINA E RE - QENDRA” NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Prishtina e Re - Qendra” në Prishtinë.

**Neni 2**

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

**Neni 3**

Me Planin rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar si “Prishtina e Re - Qendra”, e cila nga ana veriore përkufizohet me fshatin Mati 1, duke përshkruar në drejtim të zonës veriore parcelat kadastrore nr.: 409, 408, 407, 404, 406, 405, 388, 387, 386, 384, 385, 1141, 1140, 1138, 1137, 1132, 1131, 1126, 1125, 1124, 1121, 1120, 1114, 1115, 1190/2, 1190/1, 1191, 1193/2, 1193/1, 1194, 1195, 1207, 1209, 1208, 12021; në drejtim të zonës lindore me parcelat kadastrore nr.: 1020, 1360, 1386, 1393; në drejtim të zonës jugore parcelat kadastrore nr.: 637, 636, 1667, 630/1, 630/2, 624, 623, 626, 584, 601, 599, 10, 7, 1, 6; në drejtim të zonës perëndimore me parcelat kadastrore nr.: 497, 498, 499, 2817, 2816, 2815, 3004, 2712, 2, në sipërfaqe prej 360ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par. 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Bartëse e hartimit të planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, është Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Për hartimin e Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Komuna mund të ngarkojë agjenci dhe subjekte tjera, të specializuara dhe të certifikuar për hartimin e planeve hapësinore dhe urbane.

Drejtoritë tjera të Komunës së Prishtinës janë të obliguara që të sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për të cilat konsiderohet të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

#### **Neni 5**

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 6**

Plani Rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat për objektet me interes publik dhe lagje të organizuara do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në Planin rregullues të këtij kompleksi.

#### **Neni 7**

Plani rregullues "Prishtina e Re - Qendra" do të jetë në harmoni të plotë dhe kooperativ me Planin rregullues "Prishtina e Re - Lindje" dhe me Planin rregullues "Prishtina e Re" - Perëndim" dhe gjatë projektimit do të mbikëqyret nga një ekip i ekspertëve të planifikimit.

#### **Neni 8**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Pronës, të cilat do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

#### **Neni 9**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues "Prishtina e Re" në Prishtinë 01 Nr. 35-581 dt. 27.12.2006.

#### **Neni 10**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

### **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01.Nr. 35-852, më 12.5.2009**

**KRYETARI I KOMUNES**

**Prof.dr. Isa Mustafa**